

# FËMIJËT DUHET TË RRITEN DHE EDUKOHEN ME FRIKËN DHE DASHURINË NDAJ ALLAHUT

## **INTERVISTA E ADNAN OKTARIT NGA KANALI 35 (Izmir) (Shkurt 14, 2009)**

**ADNAN OKTAR:** Në qoftë se atyre nuk i mësohet të duan dhe t'i frikësohen Allahut, në qoftë se atyre nuk i mësohet të kenë mëshirë dhe nëse atyre nuk i mësohet ta duan Allahun me pasion, atëherë fëmijët e tillë do të jenë gjysëm të çmendur. Ne e shikojmë rolin e prindërve këtu. Gjithashtu ka referencë për këtë në Kur'an dhe në hadithe. Ata e lënë fëmijën e tyre në dorën e dexhalit. Dexhali e shkatarron dhe e rikthen mbrapsht te prindërit e tij; këtë herë fëmija bëhet një shqetësim për prindërit e tij. Ai rreh nënën e babain e tij dhe i qorton ato, ai bëhet me temperament të keq. Unë njoh nëna e baballarë, unë njoh plot familje që jetojnë nën një tension të madh për shkak të fëmijëve të tyre. Baballarët nuk mund të flenë rehat. I vjetri, babai ndjehet i tmerruar, fëmija bëhet agresiv kundrejt prindërve. Me qëllim që të zhduken të gjitha këto, është e rëndësishme që frika dhe dashuria për Allahun të bëhet mbizoteruese në këtë shoqëri.

## **INTERVISTA E ADNAN OKTARIT NGA KANALI (MARS 14 2009)**

**Intervistuesi :** Një djalë 17 vjeçar sipas logjikës së tij se askush nuk e merr atë seriozisht, se askush nuk e dëgjon atë dhe se askush nuk i vlerëson idetë e tij; gjen një armë dhe vret të tjerët pa brejtje ndërgjegje. Kjo gjithashtu mund të lidhet me marrëdhëniet e tij familjare, arsye mund të jetë se ai është rritur pa dashuri, apo se nuk ia ia kanë dhënë atë dashuri .

**ADNAN OKTAR:** Si mundet dikush që ka frikë Allahun të bëjë diçka të tillë?

**Intervistuesi:** VËRTET! SI KA MUNDËSI?

**ADNAN OKTAR:** Kjo ndodh kur nuk i frikësohesh Allahut.

## **INTERVISTA E ADNAN OKTARIT NGA KANALI KACKAR TV (Janar 29, 2009)**

**ADNAN OKTAR:** Nëse frika dhe dashuria ndaj Allahut iu është treguar atyre, nëse iu mësohet Kur'ani, një strukturë shumë e fortë është ndërtuar. Nganjëherë njerëzit mendojnë se nëse një fëmijë është rritur me dashurinë familjare, patjetër do të jetë më normal sesa një fëmijë i rritur pa këtë dashuri. Megjithatë, ka pasur raste në të cilat një fëmijë i cili është rritur me dashurinë familjare, e ka therur nënën e babanë e tij në copa. Kjo pra të çon në konkluzionin se dashuria e familjes nuk është më se e mjaftueshme. Dashuria e Kur'anit dhe e Allahut janë baza kryesore. Njerëzit të rritur me frikën e dashurinë e Allahut bëhët njerëz të mirë, të moralshëm, të ekuilibruar të qëndrueshem

## **INTERVISTA E ADNAN OKTARIT NGA KANALI 35 (SHKURT 1 2009)**

**ADNAN OKTAR:** Ju do të vini re se ata gjithmonë i konsiderojnë fëmijët etyre si të çmendur. Ata madje flasin në praninë etyre, ata flasin sikur po bisedonin me një të çmendur. Ata do të thoshin se është mendja e një fëmije. Në fakt fëmijët janë shumë inteligjentë. Më kujtohet se kur unë isha 3 vjeç unë kisha një ndërgjegje të hapur dhe ekonsideroja çdo gjë logjikisht. Kjo ishte, ndërgjegja ime dhe logjika ime ishte ezhvilluar plotësisht. Por, më kujtohet se ata më trajtonin mua si një fëmijë, me sa më kujtohet. Dhe unë sillsha si fëmijë vetëm që ti kënaqja ata. Unë ebëja çdo gjë me vullnet të lirë. Ata duhet të ishin të kënaqur me fëmijërinë time. Ne duhet ti trajtojmë fëmijët me respekt dhe të trajtojmë ata butësisht. Ne duhet ti trajtojmë fëmijët sinqerisht dhe me dashurinë e Allahut. Kur një fëmijë rritet dhe sheh këtë besim të sinqertë, Allahu do ta bekojë shpirtin etij dhe do t'ia hapë zemrën. Për shembull, si ishte Isai në fëmijërinë etij; si ishin profetët etjerë? Ata të gjithë ishin shumë të kultivuar qysh në fëmijërinë etyre; ata u mbërthyan në dashurinë e Allahut mprehtësisht. Fëmijët duhet të mësohen me frikën dhe dashurinë ndaj Allahut qysh në fëmijëri dhe ata duhet të trajtohen me dashuri, dhembshuri dhe me zgjuarsi. Të rritesh

me paragjykime është shumë e rrezikshme. Dua të them se njerëzit janë shumë të hapur ndaj paragjykimeve. Ata i referohen paragjykimeve kur flasin për fenë dhe fesë kur flasin për paragjykimet. Nuk ka ndonjë gjë të tillë! Feja është një sistem në të cilin një person jeton me cilësitë më të mira. Kjo është sikur të thuash, një person fetar është personi me cilësitë më mira në botë; ai është më inteligjenti, largpamësi, mendjeholli, mendjemprehti, më i besuari, i vetedijshmi, më i ndergjegjshmi dhe më i ndjejshmi. Feja është sistemi me eanë të cilit ne duhet të përfitojmë më shumë në këtë botë. Kur'ani është gjithashtu vepra artistike e Allahut që na mëson ne se si ta vëmë në përdorim në këtë botë. Nëse ne etrajtojmë më butësi fëmijën, ne do të fusnim në shpirtin etij një mëshirë të tillë që do të ishte madhështore. Por përsëri unë them, le të hyjnë të websaitat e Harun Jahjas dhe të shkarkojnë librat emi; por nëse ka diçka që nuk mund ta gjejnë aty ata mund të na shkruajnë ne, dhe ne do ti sigurojmë informacionin e përshtatshëm.

<https://www.harunyahya.info/sq/artikujt/fEmijEt-duhet-tE-rriten-dhe-edukohen-me-frikEn-dhe-dashurinE-ndaj-allahut>